



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo		
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo		
CAA		
Nr. i prot. 2024/ZDP/125		
Br. prot./ProL/ir.		
Faqe: 2	Kopje: /	Data: 04/04/2024
Stranica/Pages	Kopija/Copy	Datumi/Date
Hyrës/ulazno/in.....	<input type="checkbox"/>	
Dalës/izlazno/out.....	<input checked="" type="checkbox"/>	
Brendshëm/nterno/internal.....	<input type="checkbox"/>	Prishtinë/Pršina/Pristina

08/ZDP/VE/2024

Datë: 04.04.2024

Në mbështetje të nenit 21 paragrafit 2, nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 24 dhe 36 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative, në përputhje me Marrëveshjen për Shërbime të Rregullta Ajrore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës, të datës 30 Nëntor 2010 dhe Memorandumit të Mirëkuptimit për marrëveshje për shërbime ajrore të datës 29 Prill 2009 në mes të Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës,

Duke marrë në konsideratë Vendimin 05/ZDP/VE/2024, dt. 11 mars 2024, për shpallje të Thirrjes publike për operatorët ajror të cilët mund të ofrojnë plane fluturimi dhe kapacitete me orar të programuar fluturimesh për të fituar të drejtën e fluturimit përmes emërimit (dezinimit) në destinacionet në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe anasjelltas,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr:

VENDIM

- CAKTOHET Grupi Punues për shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar në AAC, bazuar në kriteret e shpallura në thirrjen publike, të publikuar përmes Vendimit 05/ZDP/VE/2024 të dt. 11 mars 2024, me përbërje në vijim:
 - z. Matej Krasniqi**, Inspektor i Vlefshmërisë Ajrore, AAC – kryesues;
 - z. Avdi Kamerolli**, Drejtor i Departamentit të Aviacionit Civil, MMPHI- anëtar; dhe
 - z. Granit Berisha**, Zyrtar për rregullim ekonomik të aeroporteve dhe shërbimeve të navigacionit ajror, AAC- anëtar.
- Obligohen anëtarët e Grupit Punues, të caktuar përmes pikës 1 të këtij Vendimi që të shqyrtojnë dokumentacionin e pranuar në përputhje me thirrjen publike të publikuar përmes Vendimit 05/ZDP/VE/2024.
- Pas shqyrtimit të dokumentacionit Grupi Punues do të përgatis një Raport dhe Rekomandim për Drejtorin e Përgjithshëm, bazuar në dokumentacionin e pranuar, lidhur me përmbushjen e kriterëve për të fituar të drejtën e fluturimit përmes emërimit/dezinimit në destinacionet në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe anasjelltas, deri më **19 prill 2024**.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Bazuar në marrëveshjen bilaterale në mes të Kosovës dhe Zvicrës, Autoritetit i Aviacionit Civil ka vendosur të zhvilloj një proces të përzgjedhjes së një operatori ajror për emërim/dezignim për ofrimin e shërbimeve ajrore mes dy shteteve.

Më datën 11 mars 2024, AAC ka publikuar përmes Vendimit 05/ZDP/VE/2024, thirrjen publike për shprehje interesi për operatorët ajror të cilat mund të ofrojnë plane fluturimi dhe kapacitete me orar të programuar fluturimesh për të fituar të drejtat e trafikut përmes emërimit/dezignimit në destinacionet në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës.

Kriteret që duhet të plotësohen nga Operatorët Ajror (kompanitë ajrore) që shprehin interesin për të fituar të drejtën e fluturimit përmes emërimit/dezignimit, janë bashkëngjitur Vendimit 05/ZDP/VE/2024 dhe janë publikuar në web-faqe të AAC-së.

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e dokumentacionit, të paraparë përmes thirrjes publike, në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, AAC ka kërkuar bashkëpunimin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mënyrë që të krijohet një grup i përbashkët pune i dy institucioneve, i cili do të shqyrton dokumentacionin e pranuar.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, pas dakordimit me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe në pajtim me nenin 21 paragrafin 2, nenin 23 paragrafit 1, të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, me ndryshime, nenin 24 dhe nenin 36 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenin 26 të Ligjit Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Burim Dinarama
UD Drejtor i Përgjithshëm

Iu dërgohet: Anëtarëve të Grupit Punues;
Sekretarit të Përgjithshëm, MMPHI; dhe
Arkivit të AAC-së